



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**

Numri i lëndës: 2019:214105  
Datë: 29.10.2024  
Numri i dokumentit: 06362755

**CPK.nr.101/24**  
(P.nr.376/24)

**GJYKATA THEMELORE GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen përmbartimore të kreditorit, B.D nga Gj, kundër debitorëve: K.K. me seli në P, dhe K.S, me seli në P, pas shqyrtimit të prapësimit të debitorëve të datës 23.09.2024 jashtë seancës, më datë 25.10.2024, mori këtë:

**AKTVENDIM**

- I.** Refuzohet i pabazuar prapësimi debitorit K.K. me seli në P, i datës 23.09.2024, dhe i debitorit K.S, me seli në P, i datës 23.09.2024 i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.376/24 të datës 10.09.2024 të Përmbartuesi Privat Sefer Sh. Arifi nga Gjilani, ashtu që, urdhri mbetet në fuqi.
- II.** Detyrohen debitorët që, në mënyrë solidare, kreditorit t'ia paguajnë shumën prej 156 euro në emër të përgjigjes në prapësim.

**A r s y e t i m i**

Përmbartuesi Privat, Sefer Sh.Arifi, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.376/24 të datës 10.09.2024, me të cilin e ka lejuar përmbartimin kundër debitorit, K.E.K. me seli në P, dhe K.S, me seli në P, në bazë të titullit ekzekutues -Aktgjykimit C.nr.144/2014 të datës 27.09.2019 i formës së prerë më datën 24.05.2024 dhe i ekzekutueshëm nga 12.06.2024, lidhur me borxhin për të dy debitorët në shumë të përgjithshme prej shumë prej 18, 150 Euro si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2018 Euro.

Debitorët, pas pranimit të urdhrit përmbartimor, në afat ligjor kanë paraqitur kundërshtimin e datës 23.09.2024 përkatësisht 10.09.2023. Prapësim të përbashkët e kanë paraqitur se dokumenti në bazë të të cilit është lëshuar Urdhri për Përmbartim nuk përmban tipare të përmbartueshmërisë sipas nenit 71 të LPP-së.

Debitori K.K si prapësime të veçanta ka paraqitur parregullësi gjatë zhvillimit të procesit kontestimor duke e kundërshtuar kompetencën lëndore të gjykatës së shkallës së parë për gjykimin e kërkesëpadisë së paditësit/tani kreditorit, legjitimitetin e tij, se kërkesëpadia, në kohën kur është gjykuar në gjykatën e shkallës së parë, ka qenë e parashkruar dhe shkelje të tjera që kanë ndodhur gjatë gjykimit të çështjes në procedurë kontestimore. Ndërsa, debitori K.S ka theksuar se në Gjakatën Supreme e ka paraqitur revizionin kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë.

Kanë kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi i themeltë prapësimi i debitorëve, dhe të anulohet Urdhri për Përmbarrim P.nr.376/2024 i datës 10.09.2024.

Kreditori në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetimin se nuk gjejnë mbështetje në provat dhe faktet nga dosja e lëndës. Më tutje, ka shtuar se aktgjykimi C.nr.144/2014 i datës 27.09.2010 është vërtetuar nga Gjykata e Apelit në Prishtinë, e që e ka marrë titullin e dokumentit përmbarrimor dhe se plotësisht me vend ka vepruar përmbarruesi privat kur e ka aprovuar propozimin e kreditorit duke nxjerrë urdhrin përmbarrimor. I ka propozuar gjykatës që prapësimet e debitorëve t'i refuzoj të të pabazuara dhe ta lë në fuqi urdhrin për përmbarrim, e po ashtu, i ka kërkuar shpenzime për përpilim të përgjigjes në prasim sipas Rregullores për Tarifa të OAK-së.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve, vërtetoi se prapësimet e debitorëve i datës 23.09.2024 përkatësisht 10.09.2024, janë të pabazuara, pasi nuk e kanë vërtetuar asnjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së lidhur me paraqitjen e prapësimet. Të gjitha pretendimet e debitorëve që ndërlidhen me parregullësitë e pretenduara gjatë gjykimit të kërkesës së tani kreditorit në procesin e rregullt kontestimor u gjetën të pabazuara, ngase çështja është në procedurën përmbarrimore, dhe detyrë e gjykatës është të kujdeset për çështje të tjera, e jo për çështje që janë trajtuar gjatë procesit kontestimor. Gjykata ka gjetur se dokumenti në bazë të cilit është lëshuar urdhri përmbarrimor paraqet titull përmbarrimor sipas nenit 22, par.1.1 të LPP-së, pasi aktgjykimi C.nr.144/2014, i datës 27.09.2019, është i formës së prerë nga data 24.05.2024 dhe i ekzekutueshëm nga data 12.06.2024. Po ashtu, gjykata ka gjetur se aktgjykimi është i përmbarrueshëm sipas nenit 24 të LPP-së, pasi ka skaduar afati për përmbushje vullnetare të kredisë. Gjykata thekson se paraqitja e mjetit të jashtëzakonshëm juridik është i pandikim në zhvillimin e procedurës përmbarrimore, andaj, për të gjitha këto arsye edhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të aktvendimit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit ashtu që i detyroi debitorët që në mënyre solidare kreditorit t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës përmbarrimore në shumë prej 156 euro në emër të për përgjigjes në prapësim të përpiluar nga avokati i licencuar, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifa të OAK-së, numri tarifor 6 – sipas vlerës së kredisë, dhe u kërkuar i specifikuar.

Nga të cekurat më lart, e në pajtim me nenin 5, 29, 71, 72 dhe 73 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**CPK.nr.101/2024, datë 25.10.2024**

Numri i lëndës: 2019:214105  
Datë: 29.10.2024  
Numri i dokumentit: 06362755

Gjyqtari,

Arben Xheladini

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimet të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.